



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DIBER
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TE PRONAVE DHE STREHIMIT

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, date, 22 / 02 / 2021

PËR

“ TRAJTIMIN ME BONUS STREHIMI ”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimin nr. 814, datë 03.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM Nr. 362_date 29.05.2019_Per kriteret e dhenies se subvencionit te qirase per kategorie te gezojne perparesi ne subvencionimin e qirase ne tregun e lire, me propozim te Kryetarit të Bashkisë ne mbledhjen e keshillit bashkiak te dates 3 . 3 . 2021


PROPOZON:

- I. Të miratojë listen për subvencionimin e qerases per perfituesit sipas tabelës nr. 3. bashkelidhur.
- II. Efektet financiare do të përballohen nga buxheti i shtetit dhe buxheti bashkise.
- III. Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike dhe Sektori i Administrimit te Pronave dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Vendimi ka efekt nga momenti i hyrjes ne fuqi deri ne nje vit.
- V. Vendimi i keshillit bashkiak nr. 82 date 28.05.2020 “ Per trajtimin me bonus strehimi” shuqizohet.


VI. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Diber.

P/Sektorit të Adm. të Pronave
dhe Strehimit

Gazmend Miftari



Sekretare e Këshillit Bashkiak
Inva TRUPJA



Drejtori Ekonomik
Lorenc CIBAKU




Drejtori I Shërbimeve Mbeshtetese
Shkelqim Murrja



Tabela Nr.3, Llogaritja e masës së subvencionimit të qirasë

Nr	Emër, Atësia, Mbiemër	Kategoria sipas nenit 16, të ligjit nr.22/2018	Përbëria familjare	Struktura e apart.	Sipërfaqja e apart.	Qiraja mes. e apart. në treg për strukturën që i takon familjes	Të ardhurat familjare mujore	Kategoria (sipas pikës 45, e nenit 2, të ligjit 22/2018)	Afësia përballues e sipas nenit 3 të ligjit	Qiraja e përballu eshme (h*j)	Subvenci oni në muaj (h-k)	Subvenci oni në muaj që mbulohet nga bashkia	Shuma që kerkohet nga buxheti (l-m)
1	Fatos Lutfi Mehmeti	PAK	4	2+1	68	15000	----	“ç”	0	0	15000	4500	10500
2	Xhevdet Hasan Kurti	PAK	6	2+1	68	15000	-----	“ç”	0	0	15000	4500	10500
3	Faik Selman Baçi	Ndihm ekonomike	3	1+1	63	12000	3800	“ç”	0	0	12000	3600	8400
4	Sabit Islam Gjegja	Invalid	4	1+1	68.9	12000	----	“ç”	0	0	12000	3600	8400
5	Fatbardha Mustafa Biçi	Ndihme ekonomike	2	1+1	50	12000	3200	“ç”	0	0	12000	3600	8400
6	Hurije Liman Kaza	Pensioniste	1	1+1	55	12000	----	“ç”	0	0	12000	3600	8400
7	Idajete Barjam Kote	E punesuar	3	1+1	55	12000	30506	“b”	15 %	4575.9	7424.1	2227.2	2348
8	Alma Selman Derti	Viktim e dhunes familje	6	2+1	68	15000	4500	“ç”	0	0	15000	4500	10500
9	Sokol Adem Limani	Invalid	5	2+1	68	15000	-----	“ç”	0	0	15000	4500	10500
10	Kadrie Xhafer Plaku	Nd.ekonomike	2	1+1	50	12000	3060	“ç”	0	0	12000	3600	8400



Date 23.02.2021

RELACION
PER PROJEKT VENDIMIN
PËR
“ TRAJTIMIN ME BONUS STREHIMI ”

Me vendimin nr.405, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, u miratua për herë të parë Strategjia e Strehimit Social 2016-2025, e shoqëruar me një plan veprimi konkret të detajuar, e cila nxori në pah situatën reale të strehimit, identifikoi nevojat për të mbështetur këtë sektor në kushtet e reja të reformës administrative-territoriale si dhe diktoi nevojën e një ligji të ri.

Kreu V trajton subvencionin e qirasë, sipas të cilit subvencioni i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon familjet/individët që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë dot pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale. Në këtë kre jepet mënyra e administrimit të kërkesave për planifikimin e fondeve nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë si dhe mënyra e subvencionimit të qirasë për banesat në treg të lirë.


Dhënia e subvencionit të qirasë, duke u financuar nga pushteti qendror apo nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për familjet që janë pa të ardhura ose me të ardhura të ulëta dhe nuk përballojnë dot qiranë. Në zbatim të VKM nr. 1093 date 28.12.2015 “ Per miratimin e procedurave, kriterëve dhe perparësive për dhenien e bonusit të strehimit” i ndryshuar, VKM Nr. 362_date 29.05.2019_Per kriteret e dhenies së subvencionit të qirase për kategorite që gëzojnë perparësi në subvencionimin e qirase në tregun e lirë, aplikuesit sipas tabelës nr. 3 kanë paraqitur kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin përkatës për tu trajtuar me bonus strehimi.

Per Sektorin e Administrimit të Pronave dhe Strehimit

Specialist. Veip Kaja



Përgjegjës. Gazmend Miftari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 14 Datë 03.03.2021

“ TRAJTIMIN ME BONUS STREHIMI ”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimin nr. 814, datë 03.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM Nr. 362_date 29.05.2019_Per kriteret e dhenies se subvencionit te qirase per kategorie qe gezojne perparesi ne subvencionimin e qirase ne tregun e lire, me propozim te Kryetarit të Bashkisë ne mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës **03.03.2021** sipas urdherit **633** datë **17.11.2020** miratoi me **21** vota pro **2** kunder **0** apstenim.


VENDOSI :


1. Të miratojë listen për subvencionimin e qerases për përfituesit sipas tabelës nr. 3 bashkelidhur.
2. Efektet financiare do të përballohen nga buxheti i shtetit dhe buxheti bashkise.
3. Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike dhe Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi ka efekt nga momenti i hyrjes ne fuqi deri ne nje vit.

5. Vendimi i keshillit bashkiak nr. 82 date 28.05.2020 “ Per trajtimin me bonus strehimi” shuqizohet.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Diber.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.274/1.prot.

Peshkopi, më 12.03.2021

Lënda : Per vendimin nr. 14, datë 03.03.2021 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.14, date 03.03.2021 "Për trajtimin me bonus strehimi", konstatojmë se akte administrative të kësaj natyre për vetë karakterin individual që kanë hyjnë në fuqi menjëherë sipas parashikimit të paragrafit të fundit të nenit 55/6, të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër.

PREFEKTI
Nexhbedin SHEHU

